



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2024:039932
Datë: 06.11.2024
Numri i dokumentit: 06410046

C.nr. 3234/23

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti Përgjithshëm, gjyqtarja Blerina KURTAJ, me bashkëpunëtoren profesionale Liridona Palushi, në çështjen juridike kontestimore të paditëses M. Sh. nga Gjakova, të cilët i përfaqëson sipas autorizimit Kushtrim Bunjaku avokat në Gjilan, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës-Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale-QKMF-Gjakovë, baza juridike: *Kompensim i pagës së 13-të*, vlera e kontestit: 377,00 euro, jashtë seancës, me 06 Nëntor 2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditëses M. Sh. nga Gjakova, me të cilën ka kërkuar që të DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës – Drejtoria për Shëndetësi që paditëses se lartcekur për vitin 2020, t’ia paguajë pagën e 13-të, në lartësi prej një page bazë në shumën 377,00 euro.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësja M. Sh. përmes të autorizuarit të tyre av Kushtrim Bunjaku, ka paraqitur padi kundër të paditurës, me objekt kontesti: *Kompensim i pagës së 13-të*, vlera e kontestit: 377,00 euro, duke përshtetur gjendjen faktike si në vijim: Parashtruesja e kësaj padie është e punësuar në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Gjakovë. Kjo dëshkohet edhe me kopjet e bashkangjitura të kësaj padie. Me datën 12.06.2018 hynë në fuqi Kontrata Kolektive Sektoriale, ku në bazë të kësaj marrëveshje parashtruesve të kësaj padie bazuar në nenin 17 par 2 i takon e drejta në një (1) paga në lartësinë e pagës bazë dhe atë për vitin, 2020. Përkundër obligimit ligjor që në mënyrë zyrtare

të bëhet zbatimi i kësaj kontrate lidhur më këtë padi, dhe atë brenda afatit një (1) mujor pas plotësimit të kushteve, deri me tani parashtruesja e padisë nuk është kompensuar për këtë pagë të trembëdhjetë ashtu siç parashihet në nenin 17 paragrafi 2 të Kontratës Kolektive Sektoriale për Shëndetësi. Meqenëse Kontrata Kolektive Sektoriale nuk po zbatohet zyrtarisht ashtu siç është obligimi ligjor, paditësja i është drejtuar të paditurës me kërkesë për kompensim të pagës të 13-të pikërisht në mbështetje të nenit 17 par. 2 të Kontratës Kolektive dhe ndaj të njëjtës organi përgjegjës edhe më tutje nuk ka marrë asnjë veprim qoftë për refuzimin apo përmbushjen e këtyre kërkesave. Konsiderojmë se Komuna e Gjakovës - Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale - QKMF në Gjakovë, me kohë do duhej të bënin planifikimin e duhur buxhetor edhe për këtë obligim. Për më tepër paditësja pretendon se e paditura i ka pasur mundësitë financiare për ta përmbushur këtë obligim por të njëjtin ka dështuar ta realizojë më tepër për shkak të neglizhencës në ndërmarrje të veprimeve të duhura në drejtim të realizimit të të drejtave të punëtorëve të saj. Andaj, paditësja tani kërkon nga gjykata që të ushtroj funksionin e saj dhe mos të lejoj shkeljen e të drejtave të paditëses dhe të restauroj kundërligjshmërinë e ndodhur, përkatësisht të vendos në atë mënyrë që në tërësi të respektohet përveç të tjerash parimi i përmbushjes së detyrimeve nga neni 8 i LMD në fuqi dhe pas analizimit të të gjitha fakteve dhe provave të prezantuara i propozojmë gjykatës që pas administrimit të provave kërkesëpadinë e paditëses ta e aprovojë në tërësi si të bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura, përmes përgjigjes në padi ka theksuar se: E kontestojmë në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë lidhur me pagën e 13-të, ngase me nenin 17 par.2 të Kontratës Kolektive Sektoriale (Shëndetësisë), punëmarrësit ka mundur të i kompensohet paga e 13-të, për çdo vit kalendarik në vlerë të pagës bazë sipas mundësive buxhetore të punëdhënësit, mirëpo në këtë rast punëdhënësi nuk ka pasur mundësi buxhetore që paditëses të ju bëjë kompensimin e pagës 13-të, e që rrjedhimisht që kjo kërkesë tashmë është parashkruar. Andaj, nga të lartcekurat i propozojë gjykatës që pas shqyrtimit të lëndës dhe të administrimit të provave të marr aktgjykimi refuzues.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitën e nenit 8 të LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridike civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kërkesëpadia e paditësve është në tërësi e PABAZUAR.

Gjykata lidhur me këtë çështje ka vendosur jashtë seancës gjyqësore dhe atë referuar vendimit të GJEDNJ-së *Saccoccia kundër Austrisë* (Aktgjykim i 18 dhjetorit 2008), pasi pretendimi i palës ka qenë i qartë dhe të njëjtat ngërthenin çështje ekskluzivisht ligjore të cilat nuk e kanë bërë të domosdoshme mbajtjen e seancës publike, në ndërlidhje edhe me natyrën jo komplekse të çështjes, e në ndërlidhje me nenin 399 par.1 të LPK-së që përcakton se “*Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës, atëherë ajo do te jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia*”.

Në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se pala paditëse ishte e punësuar tek e paditura dhe se gëzonte shpërblimin në emër të pagës bazë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, mirëpo kontestuese ishte baza e kërkesëpadiës, pra nëse palës paditëse i takon apo jo e drejta lidhur me kompensim të pagës se 13-të të papaguar.

Në bazë të kontratës mbi marrëdhënien e punës, me numër protokollit 252 të dt. 30.03.2018, e lidhur në mes të Komuna Gjakovë - Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale-QKMF-Gjakovë, në cilësi të punëdhënësit dhe M. Sh. në cilësi të punëmarrëses, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja ka të themeluar marrëdhënien e punës tek e paditura me kohë të pa caktuar nga data 01.04.2012, dhe gëzon shpërblimin në pagën bazë prej 377.00 euro, fakt i cili nuk ishte kontestues në mes të ndërgjyqësve.

Gjykata lidhur me bazën e kërkesëpadiës, ka vendosur duke u bazuar në nenin 17.2 të Kontratës Kolektive Sektoriale e datës 12.06.2018, e lidhur në mes të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, ku përcaktohet se “*Punëmarrësi mund të kompensohet me pagën e 13 – të për çdo vit kalendarik, në vlerën e pagës bazë, sipas mundësive buxhetore të punëdhënësit*”.

Në interpretim të kësaj dispozite ligjore, çështja e kompensimit të pagës së 13-të, për punëtorët shëndetësor është e kushtëzuar me mundësitë financiare të punëdhënësit, përkatësisht nëse ka mjete buxhetore. Nga kjo rezulton se dispozita e sipër theksuar duhet interpretuar në atë mënyrë që e drejta për realizimin e pagës së 13-të, lind kur punëdhënësi nuk e përmbush atë, ndërsa në asnjë mënyrë nuk arrin të provojë se nuk ka pasur mundësi buxhetore. Sipas kësaj gjykate, nëse

punëtori paraqet kërkesë për kompensimin e shpërblimit të pagës së 13-të, duke pretenduar se ka plotësuar kushtet e përcaktuara, mbetet në barrën e punëdhënësit që në secilën fazë të procedurës kur gjykata i jep mundësi për t'u deklaruar me prova konkrete, të provoj çështjen e mundësisë buxhetore për shpërblimin e tillë. (*Mendim Juridik i miratuar në Seancën e Përgjithshme të Gjykatës Supreme, të datës 09 tetor 2023*).

Sipas Ligjit mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, buxheti fillestar për paga dhe mëditje në Komunën e Gjakovës ka qenë 13,817,893 euro. Në nenin 12 par. 6 të këtij Ligji është përcaktuar se: *“Shpenzimi i parave publike nga kategoria e shpenzimeve mallra dhe shërbime nuk është i lejuar për pagesën e punonjësve, qoftë në formë të shtesave apo si kontribute në mall, përfshirë këtu shujtat apo dhuratat, duke përjashtuar rimbursimin apo shpenzimet e lejuara për udhëtimet jashtë vendit, sipas legjislacionit përkatës”*. Përderisa sipas raportit auditimit për komunën e Gjakovës për vitin financiar të përfunduar më 31 dhjetor 2020 të publikuar nga ZKA, rezulton se buxheti final për paga dhe mëditje ka qenë në shumën prej 14,263,962.78 euro ndërsa realizimi për vitin 2020 ka qenë 14,242,132.73 euro, apo shprehur në përqindje është realizuar gati 100%. ZKA-ja ka konstatuar se buxheti final për paga dhe mëditje në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 446,070 euro dhe kjo rritje ishte një reflektim i pranimeve nga donacionet, të hyrave vetanake dhe atyre të bartura nga viti i kaluar, pastaj rritja buxhetore nga huamarrja dhe linja vertikale si dhe rimëkëmbja ekonomike. Sipas këtij raporti rezulton se për shkak të situatës me pandeminë me Covid-19 komuna e Gjakovës kishte shpenzuar buxhet të ndarë për këtë qëllim në vlerë totale prej 1,188,659 euro, prej të cilave 889,674€ ishin për shtesa në paga dhe mallra e shërbime për menaxhimin e emergjencës nga COVID-19.

Nga Ligji përkatës të cituara si më lartë, përkatësisht në raport me zërat për ndarje buxhetore, rezulton se Komuna e Gjakovës nuk ka ndarë asnjë linjë buxhetore për paga të 13-ta për vitet 2020-të, e në anën tjetër realizimi i buxhetit për paga dhe mëditje është realizuar në atë masë sa nuk rezulton rezervë buxhetore për të mbuluar pagat e 13-ta për punonjësit, përkatësisht në rastin konkret paditësen.

Nga interpretimi dhe arsyet si më lartë, gjykata ka vendosur që të refuzojë në tërësi kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar.

Gjykata ka vlerësuar dhe pretendimet e tjera të palës paditëse e po ashtu edhe asaj të paditur, por të njëjtat nuk kishin ndonjë rëndësi për vendosje ndryshe nga ana e gjykatës, sepse padisë i ka munguar baza juridike.

Lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore, gjykata ka vendosur bazuar në nenin 450 “*Secila palë paraprakisht vetë i bartë harxhimet që i ka shkaktuar me veprimet procedurale të veta*”, e lidhur me nenin 463.1 “*Për pagimin e shpenzimeve procedurale gjykata vendosë vetëm me kërkesën e specifikuar të palës, pa bërë asnjë shqyrtim verbalisht lidhur me kërkesën*”-të LPK-së.

Nga sa u tha më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e bazuar në nenin 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
C.nr. 3234/23, me 06 Nëntor 2024

Gj y q t a r ja:
Blerina KURTAJ

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve, pas pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.

Numri i lëndës: 2024:039932
Datë: 06.11.2024
Numri i dokumentit: 06410046